



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punehetë/Pradato Received/Delivered	05-09-2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHICK	5961/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.950/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga:Arben Mehmeti-kryetar,Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë,si dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.950/2022 të datës 12.07.2023, të parashtruar nga ankuesja me adresë

kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.950/2022 e datës 12.07.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 16.05.2023 ka shpallur ftesë për aplikim për Zyrtar Korrektues Grada I-katër vende, në Qendrën Operative - Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, në të cilën ka aplikuar edhe ankuesja.

Pas rezultatit të testit me shkrim dhe me gojë, sipas listës përfundimtare rezulton se ankuesja ka marrë 63% të pikëve nga të dy vlerësimet, si rrjedhojë nuk ka qenë në mesin e katër kandidatëve me më së shumti pikë.

Kundër këtij vlerësimi me datë 13.06.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa Komisioni i Ankesave i Shërbimit Korrektues më datë 30.06.2023 ka nxjerr Vendimit me ë cilin është shpall jo kompetent për të vendosur për ankesën.

Ankuesja më datë 12.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5131/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për procedurën e shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 18.07.2023 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa, Këshilli më datë 20.07.2023 dhe 21.08.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 24.08.2023 ka nxjerr Vendim me numër protokollit 5802/2023 për shtyrje të afatit për vendosje të ankesës së ankueses për 10 ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5131/2023 e datës 12.07.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Listën përfundimtare e datës 12.06.2023; Listën e zyrtarëve që kanë kaluar testin me shkrim e datës 06.06.2023; Vendimin e datës 30.06.2023 të Komisionit të Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.07.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 20.07.2023 dhe 21.08.2023; Ftesë për aplikim e datës 16.05.2023; Lista e zyrtarëve aplikues për Zyrtar Korrektues në Qendrën Operative; Kërkesën për punësim të ankueses, Kontratë Punë për kohë të pacaktuar e datës 30.06.2018 e ankueses, Diplomën e datës 15.06.1990, Vlerësimin e rezultateve në punës i datës 12.01.2023, Testin me shkrim të ankueses i datës 02.06.2023; Kërkesën për punësim të kandidatit _____, Vërtetimin e datës 23.05.2023, Akt Emërimin AE.Nr.053/2022 i datës 24.06.2022, Diplomën e datës 04.09.2008; Kërkesën për punësim e kandidatit _____, Vërtetimin e datës 23.05.2023, Akt Emërimin AE.Nr.054/2022 i datës 24.06.2022, Diplomën e datës 11.06.2018; Kërkesën për punësim të kandidatit _____, Vërtetimin e datës 23.05.2023, Akt Emërimin AE.Nr.051/2022 i datës 24.06.2022, Diplomën e datës 19.09.2011; Kërkesën për punësim e kandidatit _____, Vërtetimin e datës 22.05.2023, Kontratë punë për kohë të pacaktuar e datës 15.07.2020, Ndryshimin dhe plotësimin e kontratës e datës 17.12.2019, Diplomën e datës 12.0.2011, Vlerësimin e rezultate në punë i datës 17.01.2022; Çelësin e testit me shkrim; Testin me shkrim të kandidatit _____ dhe _____ Vendimin e datës 29.05.2023 për themelimin e komisionit ad-hoc për vlerësimin e njohurive dhe aftësive fizike për zyrtar korrektues për kalim në Qendrën Operative; Listën e zyrtarëve që i kanë plotësuar kushtet e datës 30.05.2023; Vendimin i datës 30.06.2023 për caktimin komisionit ad-hoc për shqyrtim të ankesës; Kërkesë e datë s04.09.2023 nga _____ për _____ Njoftimin e datës 04.09.2023 nga _____

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e papabazuar, **sepse:**

Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore i'u referua nenit 4 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *"1.Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë..."* dhe si rrjedhojë konstatoi së nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civilë si dhe ligjeve të veçanta lidhur me elementet e marrëdhënies së punës që kanë të bëjnë me: *"1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve"*.

Bazuar në këtë Shërbimi Korrektues i Kosovës, ka publikuar ftesën për aplikim të datës 16.05.2023, me qëllim që të gjithë Zyrtarët Korrektues të Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë mund të aplikojnë për të njëjtën pozitë pa ndryshim tw aktit tw emwritit vetëm që vendi i punës të jetë në Qendrën Operative të kësaj qendre, dhe kushtet e parapara kanë qenë: *"Të ketë pozitë zyrtar korrektues; Të mos ketë masë disiplinore aktive; Të ketë aftësi shume të mira komunikimi; Të ketë aftësi profesionale në përpilim të raporteve; Obligatorë, njohja e programeve kompjuterike Word, Exel etj, (Programet tjera shtesë të avancuara janë përparësi); Njohja e gjuhëve të juaj Anglisht dhe Serbisht (e preferuar) E dëshiruar njohja dhe përdorimi i databazave të SHKK-së"*.

Bazuar në kriteret e paraparë në ftesë për aplikim është zhvilluar procedura e testit me shkrim ku ankuesja ka marr gjithsej 66 pikë dhe është nënshtuar intervistës me gojë ku nga pikët e marra nga tre anëtarët e Komisionit të Vlerësimit ka marr gjithsej 60 pikë, rrjedhimisht nga testimi me shkrim dhe me gojë në rezultatin përfundimtar ka marr gjithsej 63 pikë, ndërsa në listën përfundimtare janë gjashtë (6) kandidatët që kanë numrin më të madh të pikëve në raport me ankuesen, me çka rezulton se sipas listës përfundimtare ankuesja nuk ka marr pikët për të qenë në mesin e katër (4) kandidatëve me më së shumti pikë e që do të ishte kandidate e rekomanduar.

Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi i kërkesave për punësim të ankueses dhe katër kandidatëve me më së shumti pikë, konstaton se të gjithë kanë plotësuar kushtet të cilat janë përcaktuar në thirrjen për aplikim, dhe mbi këto konstatime nuk është evidentuar ndonjë shkelje e të drejtave nga marrëdhënia e punës së ankueses.

Shërbimi Korrektues i Kosovës, përmes emailit të datës 04.09.2023 ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës se kjo procedurë është procedurë e thjeshtësuar dhe është konsideruar e nevojshme për shkak të natyrës së punës së Qendrës Operative në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinës dhe në bazë të procedurave këtu nuk kemi të bëjmë me ndryshim të statusit, kontratës apo akt emërimit, po ashtu nuk kemi as ndryshim të pagës apo ndonjë beneficioni tjetër.

Kolegji i Këshillit, marr parasysh specifikat e Shërbimit Korrektues të Kosovës, dhe duke marr parasysh që me anë të kësaj thirrje për aplikim ankueses nuk i është cenuar e drejta për aplikim, mirëpo nga provat e lëndës, është konstatuar se rezultati përfundimtar ka ndikuar që ankuesja mos të ketë numrin më të madh të pikëve në raport me zyrtarët e tjerë që kanë numër më të madh të pikëve, mbi këtë bazë edhe pretendimet e ankueses janë të pabazuara dhe e njëjta nuk ka mund që me prova materiale të vërtetoj pretendimet e saj.

Kështu që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.950/2023, datë 05/09/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

